REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 880/20
Datë/Datum. 02.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: KOMUNA PRIZREN

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **622-20-2658-5-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Ndërtimi i banesave kolektive për banim social në Prizren**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Konsorciumi: N.P.N. "Alfa-Ing" & "BM GROUP" SH.P.K. & "Renelual Tahiri" SH.P.K.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Pellazgeve nr18A / Prizren 20000
(Adresa)

Prizren *(Vendi)*

20000 *(Kodi postar)*

+383 49 135337 *(Numri Telefonit)*

N/A *(Numri i Faks-it)*

Ridvan Elezi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

alfapz4@hotmail.com;
(Adresa elektronike)

02.11.2020________________________
(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

NDËRMARRJA PROJEKTUESE NDËRTIMORE TREGTARE ALFA ING. PRIZREN

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë si dhe Dosja e Tenderit janë publikuar me datën 09.06.2020 në faqen zyrtare e-prokurimi.rks-gov.net prej nga edhe i kemi shkarkuar Dosjen e Tenderit dhe Paramasën.

Dorëzimi i dosjes nga kompania jonë është bërë me datën 21.09.2020 në mënyrë elektronike përmes e-prokurimi.rks-gov.net. Procesi i hapjës së tenderit është bërë me datë 21.09.2020 nga ora 14:00.

Me datën 16.10.2020 AK ka publikuar "B58 NJOFTIM PER VENDIMIN E AK-1" përmes platformës e-prokurimi.rks-gov.net. Ku si fitues të propozuar për kontratë është shpallur Operatori Ekonomik "ALBOSS" SH.P.K.

Me datën 16.10.2020 kemi kërkuar qasje në dokumentacionin e tenderuesit të propozuar për nënshkrim të kontratë dhe qasja na eshte aprovuar permes emailit me datë 19.10.2020. Dhe me datë 19.10.2020 duke filluar nga ora 10:00 kemi pasur qasje në dokumentacionin e tenderuesit të propozuar për nënshkrim të kontratës.

Me datë 19.10.2020 përmes emailit dhe faqes së e-prokurimit kemi dërguar Kërkesën për rishqyrtim tek Ak.

Me datë 26.10.2020 përmes emailit dhe faqes së e-prokurimit kemi pranuar Përgjigjjen per Kërkesën për rishqyrtim nga AK. AK ka marrë vendim që të Refuzohet kërkesa për rishqyrtim dhe të vazhdohet me vendimin per kontrate si fitues është shpallur Operatori

Ekonomik “ALBOSS” SH.P.K.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☐ Jo ☐

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ankesa jonë ka të bëjë me Ri-shikimin në përcaktimin e Operatorit Ekonomik fitues, kështu që mendojmë që AK :

KA BËRË SHKELJE TË LIGJIT TË PROKURIMIT PUBLIK NË NENET E MËPOSHTME:

1. **Neni 12 – LPP-së**
2. **Neni 69 - LPP-së**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me datën 16.10.2020 AK ka publikuar "B58 NJOFTIM PER VENDIMIN E AK-1" përmes platformës e-prokurimi.rks-gov.net. Ku si fitues të propozuar për kontratë është shpallur Operatori Ekonomik "ALBOSS" SH.P.K.

1. Nuk është respektuar **Neni 12 pika 1 dhe 2 e LPP-së** Neni 12 Valutat, Pagesat dhe Kushtet e Zakonshme të Kontratës 1. Të gjitha çmimet dhe vlerat e specifikuara në çfarëdo kontrate publike, dosje të tenderit, njoftim, ftesë për tender ose pjesëmarrje, duhet të deklarohen dhe të gjitha pagesat e tyre duhet të bëhen në Euro. 2. Kushtet dhe termet e kontratave publike duhet të jenë në përputhje me praktikat e zakonshme publike dhe afariste për llojin dhe lëndën e veçantë të kontratës përkatëse.

   Ne Paramasen e ofruar nga OE "ALBOSS" SH.P.K tek rikapitulimi i puneve te mbindertimit OE ne fjale e perdor simbolin e valutës $,

2. Nuk është respektuar Neni 69 e LPP-së Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
   Nuk e plotëson Kërkesën 1. *"Projektet e natyrës së kontratës të realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit te ketij njoftimi) vlera minimale e të gjitha projekteve të natyrës së Kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 1.900.000 €"*

OE në fjalë arrin një total të kontratave me vlerë: "1.591,187.39€ "
Kjo pasi qe disa nga kontratat nuk janë të natyrës së njejte:
1.Ndërtimi I Terenit sportive ne Lagjen 11 Marsi ne Prizren, me nr të prokurimit 622-18-096-521. – 119,567.70€
2.Krijimi I ambientit ne Kabash dhe Korish si destinacion turistik, me nr të prokurimit 622-18-117-521. – 71,087.00€
3.Demolimi I sipërfaqes Charlie ne kampin fushor Prizren. – 444,695.00€

Ndersa tek Lista e Kontratave, Kontratat me numer 30,31,32,33,34,35,36,37,38,39,40,41,42,43. Jane me te vjetra se 3vite

Gjithashtu kerkojme nga OE qe ti ofroje Kontratat dhe Paramasat ne oregjinal te kontraktuara nga "Headquarters Kosovo Force – KFOR"

Për Grupin e Operatorëve Ekonomik të tjerë Autoriteti Kontraktues ka zbatuar ligjin e prokurimit dhe rregulloren duke u mbeshtetur në nenet dhe në dokumentet qe Ata si OE nuk i plotësojnë kushtet dhe nuk janë të përgjegjshëm për realizimin e projektit.
Për OE - CONSTRUMAX SH.P.K., Rr. Mentor Krasniqi p.n. Bukosh, 23000, Suharekë
:
[Ju jeni diskualifikuar] [Tenderi juaj është refuzuar] për këto arsye : ***Ju mungojnë :***
1.Certifikim OHSAS 18001 për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë

Ne si OE pajtohemi me vendimin e AK ne lidhje me OE - **CONSTRUMAX SH.P.K.**
AK duke rrespektuar ligjin e LPP dhe RROUPP respektivisht , Nenin 69 te LPP dhe Neni 39-te Rroupp-së .

Për Grupin i OE Grup i Operatorëve Ekonomik B Ademaj SH.P.K.; MBB Construction SH.P.K.; N.T.P."GRESA - COMMERCE ", zhur prizren, -20520, ZHUR pn mungojnë:
1. Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera,minimale e të gjitha projekteve të
natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 1.900.000,00 €.

2.të ketë në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike a së paku 2 kamion të tonazhit nga 5 10 ton (pesha bartëse). b. Kran për bartjen e peshave në lartësi. c. skele të mjaftueshme për ndërtim dhe suvatim të jashtëm të objektit. (Ju mungon një kamion 5 -10 to –pesha bartëse).

3.Certifikim OHSAS 18001 për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë.
AK duke rrespektuar ligjin e LPP dhe RROUPP respektivisht , Nenin 69 te LPP dhe Neni 39-te Rroupp-së .

Ne si OE pajtohemi me vendimin e AK ne lidhje me GOE - **B Ademaj SH.P.K.; MBB Construction SH.P.K.; N.T.P."GRESA - COMMERCE "**AK duke rrespektuar ligjin e LPP dhe RROUPP respektivisht , Nenin 69 te LPP dhe Neni 39-te Rroupp-së

Për Grupin i OE Grup i Operatorëve Ekonomik N.P.T. Loni ; V - SHALA SH.P.K., ADEM JASHARI 169, -, PEJË mungojnë:
1. të ketë në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike a së paku 2 kamion të tonazhit nga 5 10 ton (pesha bartëse). b. Kran për bartjen e peshave në lartësi. c. skele të mjaftueshme për ndërtim dhe suvatim të jashtëm të objektit. (Ju mungojnë 2 kamion 5 -10 ton –pesha bartëse).

Ne si OE pajtohemi me vendimin e AK ne lidhje me GOE - **.P.T. Loni ; V - SHALA SH.P.K."**AK duke rrespektuar ligjin e LPP dhe RROUPP respektivisht , Nenin 69 te LPP dhe Neni 39-te Rroupp-së

5 -10 to –pesha bartëse).

Ne si OE pajtohemi me vendimin e AK ne lidhje me GOE - . **N.N.T. Etniku ; KAG - Asphalt Company SH.P.K** "AK duke rrespektuar ligjin e LPP dhe RROUPP respektivisht , Nenin 69 te LPP dhe Neni 39-te Rroupp-së

PROPOZIMI JONE:

Të APROVOHET ankesa e OE "Alfa-Ing" N.P.N. si e bazuar.

Të ANULOHET Njoftimi dhe Vendimi i AK-së për dhënic të kontratës

Të DETYROHET, autoriteti kontraktues që Rivlerësimi i ofertave të bëhet konform dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të FTD-së dhe të njoftimit për kontratë.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *Një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
c) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë;*
d) *Kerkesa per rishqyrtim e dorezuar tek AK*
e) *Njoftim Mbi Vendimin E Autoritetit Kontraktues*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*